



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.716/ 8 prot.

Datë 31.03.2026

V E N D I M

Nr. 448/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), mbi pretendimet e pranuar plotësisht të paraqitura nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, për procedurën e prokurimit “*E hapur - mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt “*Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville*”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhjetë e tre milion e katerqind e katermbedhjetë mijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Ankimues:

BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) me NUIS L21512022F me adresa: Njesia Bashkiake nr.8, rruga

"Qemal Stafa", shkalla 1, kati 0, perballe Qendres Lincoln, ZK 8370, nr pasurie 9/, Tiranë & "ARABEL" SHPK & "Transport Highway Consulting" SHPK & "Civil Cons" Shpk.

Autoriteti Kontraktor: Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a me adresë: Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik "GJEOKONSULT & CO" Shpk me NIPT K91810005U dhe adresë: Njesia Administrative Nr. 05, Rruga Sami Frasheri, Pallati Nr. 45, Shkalla 01, Kati i pare, Zona Kad, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lart monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.11.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt “Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhete e tre milion e katerqind e katermbedhete mije e gjashteqind e shtatedhete e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Kamëz Sh.a.

II.2. Në datën 29.12.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 20.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | | |
|---|---------------|----------------|
| 1. INSTITUTI DEKLIADA-ALB shpk | 48,073,205 | I skualifikuar |
| 2. BOE GRAMA shpk & ZENIT & CO shpk | 48,073,205.28 | I skualifikuar |
| 3. BOE InfraKonsult shpk
& “ARABEL” SHPK
& “Transport Highway Consulting” SHPK
& “Civil Cons” Shpk | 48,100,000 | I kualifikuar |
| 4. GJEOKONSULT & CO shpk | 52,346,378 | I skualifikuar |

II.4. Në datën 28.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku fitues është shpallur BOE “InfraKonsult shpk” & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 10 datë 02.02.2026.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi nr. A/2026/6303, si dhe nr. protokollit 336/2026 datë 03.02.2026 e operatorit ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik

“GJEOKONSULT & CO” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në datë 02.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.318/2026, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt "Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhete e tre milion e katerqind e katermbedhete mije e gjashteqind e shtatedhete e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, në zbatim të Vendimit të KSHA-së me nr. 124/5 prot., datë 24.02.2026, duke e skualifikuar këtë BOE.
3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK, duke e kualifikuar atë në zbatim të vendimit të KSHA.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.7. Në datë 12.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.336/2026, ku vendosi:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt "Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhete e tre milion e katerqind e katermbedhete mije e gjashteqind e shtatedhete e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi I dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.8. Në datën 05.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6390, me nr. protokoli 716/2026 datë 05.03.2026, e cila figuron me statusin e pa paguar si dhe ankimi elektronik me nr. A/2026/6391, me nr. protokoli 716/1/2026 datë 05.03.2026, e BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, **ku janë të njëjtat pretendime si në formular ankese me numër ankimi elektronik A/2026/6390**, me statusin e paguar mandat pagesa për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimi e vendimmarrjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.9. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 716/2 prot., datë 05.03.2026.

II.10. Më datë 13.03.2026, nëpërmjet shërbimit postar, BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, ka dërguar materialin shtesë ankese, protokolluar me tonën me nr. 716/3 prot., datë 13.03.2026.

II.11. Me shkresën me nr .716/4 prot., datë 24.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik, i është drejtuar me shkresë autoritetit kontraktor, të dërgoi informacion mbi shqyrtimin e ankesës në përmbushje të nënit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

II.12. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse me nr. 655/1 prot, datë 27.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 716/5 prot., datë 30.03.2026, me objekt: “Dërgim informacioni”.

II.13. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, i ndryshuar, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

Arsyeton:

III.1. Në datën 27.11.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt “Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhjetë e tre milion e katerqind e katermbedhjetë mijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Kamëz Sh.a.

III.1.1. Në datën 29.12.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.1.2. Në datën 20.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | | |
|---|---------------|----------------|
| 5. INSTITUTI DEKLIADA-ALB shpk | 48,073,205 | I skualifikuar |
| 6. BOE GRAMA shpk & ZENIT & CO shpk | 48,073,205.28 | I skualifikuar |
| 7. BOE InfraKonsult shpk
& “ARABEL” SHPK
& “Transport Highway Consulting” SHPK
& “Civil Cons” Shpk | 48,100,000 | I kualifikuar |
| 8. GJEOKONSULT & CO shpk | 52,346,378 | I skualifikuar |

III.1.3. Në datën 28.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku fitues është shpallur BOE “InfraKonsult shpk” & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 10 datë 02.02.2026.

III.1.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi nr. A/2026/6303, si dhe nr. protokollit 336/2026 datë 03.02.2026 e operatorit ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III.1.5. Në datë 02.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.318/2026, ku vendosi:

8. *Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt "Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhjetë e tre milion e katerqind e katermbedhjetë mijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a.*
9. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, në zbatim të Vendimit të KSHA-së me nr. 124/5 prot., datë 24.02.2026, duke e skualifikuar këtë BOE.*
10. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK, duke e kualifikuar atë në zbatim të vendimit të KSHA.*
11. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
12. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK.*
13. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
14. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.6. Në datë 12.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.336/2026, ku vendosi:

3. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt "Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhjetë e tre milion e katerqind e katermbedhjetë mijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a.*
4. *Kopje e këtij vendimi I dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.7. Në datën 05.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6390, me nr. protokolli 716/2026 datë 05.03.2026, e cila figuron me statusin e pa paguar si dhe ankimi elektronik me nr. A/2026/6391, me nr. protokolli 716/1/2026 datë 05.03.2026, e BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport

Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, **ku janë të njëjtat pretendime si në formular ankese me numër ankimi elektronik A/2026/6390**, me statusin e paguar mandat pagesa për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimi e vendimmarrjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III.1.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 716/2 prot., datë 05.03.2026.

III.1.9. Më datë 13.03.2026, nëpërmjet shërbimit postar, BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, ka dërguar materialin shtesë ankese, protokolluar me tonën me nr. 716/3 prot., datë 13.03.2026.

III.1.10. Me shkresën me nr .716/4 prot., datë 24.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik, i është drejtuar me shkresë autoritetit kontraktor, të dërgoi informacion mbi shqyrtimin e ankesës në përmbushje të nënit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

III.1.11. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse me nr. 655/1 prot, datë 27.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 716/5 prot., datë 30.03.2026, me objekt: “Dërgim informacioni”.

III.1.12. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton, se në datën 05.03.2026, datë në të cilën BOE ankimues ka paraqitur ankese në sistemin elektronik të ankesave me ankimim elektronik me nr. A/2026/6391, me nr. protokoll 716/1/2026 datë 05.03.2026, njëkohësisht si në Komisionin e Prokurimit Publik dhe në autoritet kontraktor, ky i fundit, akoma nuk ka publikuar as njoftimin e fituesit, as njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit, në sistemin e prokurimit elektronik.

III.1.13. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ndryshuar, parashikon se:

“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.

Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike.”

III.1.14. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.15. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*“2. Në procedurat e prokurimit **mbi kufirin e lartë monetar**, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit**.*

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

*8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. **Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**”.*

III.1.16. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.17. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e*

procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës)."

III.1.18. Në nenin 114, pikat 1, 4, 5 dhe 6, "Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"1. Në rastet e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

"4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik".

III.1.19. Në nenin 115 pika 1, "Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik" i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *"1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.”

III.1.20. Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

Neni 97 “Afatet për paraqitjen e ankesave”, pika 5, i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatese.”

III.1.21. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 10 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret, BOE ankimues BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me nr.

A/2026/6391, me nr. protokollit 716/1/2026 datë 05.03.2026, e BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, **ku janë të njëjtat pretendime si në formular ankese me numër ankimi elektronik A/2026/6390**, me statusin e paguar mandat pagesa për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Ndërkohë, nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton se, nga ana e autoritetit kontraktor në këtë datë, pra 05.03.2026, nuk është publikuar as njoftim - fituesi e as njoftimi i anulimit të procedurës.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, BOE ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit**. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”, pasi në datën 05.03.2026 (data që BOE ankimues ka paraqitur ankesën online), nuk ishte publikuar as njoftim fituesi e as njoftimi i anulimit të procedurës.

Neni 97 “Afatet për paraqitjen e ankesave”, pika 5, i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.”

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nga e nesërmja e ditës së publikimit të njoftimit të fituesit ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 10-të, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar.

Në rastin konkret, më datë 05.03.2026, afati i paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, nuk kishte filluar ende, për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit, apo njoftimi i anulimit të procedurës, që do të thotë se operatorit ekonomik ankimues nuk i kishte lindur akoma e drejta e ankimit. Për sa më sipër, ankesa dorëzuar në datën 05.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e BOE ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dy institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga BOE ankimues në sistemin e ankesave elektronike, nuk ka përmbushur

detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit në autoritet kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.22. Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar parashikohet se: “ *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga BOE ankimes, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, në procedurën e prokurimit “*E hapur - mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt “*Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville*”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhjetë e tre milion e katerqind e katermbedhjetë mije e gjashtëqind e shtatedhjetë e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a.
2. Autoriteti kontraktor nuk mund të lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, deri në shqyrtimin e plotë të formularit të ankesës së BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk me nr. Ankimimi elektronik A/2026/6465 me nr. 969 Prot., me datë 31.03.2026.

3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highway Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

